

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 6”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, Z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshëndetje! Sot në datën 24.05.2024, do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 6, me ankues Partia Ardhmëria Shqiptare, me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 38, datë 9.04.2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike, për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, të KSHZ. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 6 dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë nga një përfaqësues i administratës. Pesë shiritat e futur në gogla do të futen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ-ja që do të tërheqë goglat, në emër dhe për llogari të tyre, për caktimin e relatorit. Fillojmë me përzgjedhjen e goglave. Pasi përzjejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjitës, duke filluar nga:

Zoti Elvin Lako: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me:

Zotin Elvis Çefa: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me:

Zotin Ilirjan Rusmali: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2024*

Vazhdojmë me:

Zotin Koli Bele: – Kërkesa ankimore nr. 6.

Vazhdojmë me:

Zotin Ledio Braho: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, zoti Koli Bele është relator i kërkesës ankimore nr. 6.

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

